




Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT DHJETOR

Dhjetor, 2023



PËRMBAJTJA

1	METODOLOGJIA	3
2	TË GJETURAT KRYESORE	5
3	SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE	6-9
4	SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE	10

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT DHJETOR DHE ÇRREGULLIMET E INFORMACIONIT

1 Koha e monitorimit

1-31 dhjetor 2023.

2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube, TikTok dhe Instagram.

3 Mostra

Në gjuhën shqipe dhe serbe.

4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i çrregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit dhjetor në Kosovë.

Ky raport është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbulueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje i përhapjes së lajmeve me çrregullim të informacionit. Institutit D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformatë, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm. Kategoritë të cilat kanë mbizotëruar gjatë muajit nëntor në mostrën e gjuhës shqipe kanë qenë: mizogjenia, gjuha e urrejtjes, zhvillimet në veri, ndasitë dhe polarizimi politik kurse në mostrën në gjuhën serbe mbetet zhvillimet në veri.

Prej secilës mostër janë verifikuar 1000 artikuj me lexueshmëri më të madhe. Në mostrën në gjuhën shqipe nga 1000 artikuj, rreth 300 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit, kurse në mostrën në gjuhën serbe nga 1000 artikuj të analizuar, rreth 260 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

3. TË GJETURAT KRYESORE

- Mizogjenia dhe Gjuha nxitëse ndaj grave në Kosovë - gjatë monitorimit të lajmeve në mostrën në gjuhën shqipe janë vërejtur tituj me gjuhë fyese dhe nxitëse ndaj figurave publike, veçanërisht grave në politik duke përdorur tituj të ekzagjërues me terma ofendues. Raportimet e njëanshme dhe me gjuhë ofenduese nxisin qytetarët që të përforcojnë gjuhën e urrejtjes ndaj grave dhe cunon përfshirjen e grave në fushën e vendimmarrjes për shkak të gjuhës së përdorur kundër tyre dhe paragjyqimeve .
- Polarizimi politik/ gjuhë ofenduese- në muajin dhjetor, në mostrën në gjuhën shqipe, kanë çarkulluar edhe narrative me qëllim të polarizimit politik, përmes titujve të ekzagjërues dhe me gjuhë fyese ndaj figurave politike në Kosovë. Narrativat në fjalë rrënjosin edhe më thellë gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale duke nxitur gjuhë të urrejtjes në mes të ndjekësve të mediave në rrjete sociale, gjë që shton ndasitë politike.
- Teoritë konspirative- sikurse është evidentuar në muajt paraprak në sferën mediatike në Kosovë, edhe muaji dhjetor karakterizohet me shumë artikuj që kanë si përmbajtje supozimet se një sulm i dytë nga Serbia është i mundur. Supozimet në fjalë lënë hapsirë për lexuesit që të merren gabimisht si të vërteta, dhe ndodh që të përhapen informata të paverifikuara, të cilat mund të jenë të pa bazuara, siq janë shembujt në këtë raport ku janë paraqitur artikujt të publikuar vetëm në muajin dhjetor nga portali Bota Sot.
- Propagandë dhe lajme të paverifikuara- Në shembullin në gjuhën serbe, vazhdojnë narrativat e paverifikuara kundër figurave politike në Kosovë ngjashëm me muajt paraprak. Këto narrativa shpërfaqen nga personat zyrtarë të fushës politike në Serbi dhe nga mediat të cilat kanë krijuar narrativën e torturave dhe terrorizimit ndaj komunitetit serb në veri. Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, mediat serbe e shohin Kryeministrin Albin Kurti si problem kryesor i tensioneve midis dy shteteve.

4. SHEMBUJ NË GJUHËN SHQIPE

Mizogjenia

Kur flitet për monitorimin dhe analizimin e mediave dhe rrjeteve sociale, Instituti D4D tash e tre vite i ka kushtuar vëmendje të veçantë gjuhës mizogjene ndaj grave dhe vajzave në politike. Ndodh që këto raste të publikohen e të bëhen virale.



Rasti në fjalë lidhet me një kryefamiljar nga diaspora, Kujtim Lushaj, i cili ka postuar një foto familjare me komentin “ Quhem Kujtim Lushaj Albin Kurtit ja kisha 2 qikat e mia per me ba naj nip inteligjent si Albini që është“ dhe mori 50 pëlqime dhe 7 shpërndarje. Postimi mori vëmendjen e portaleve dhe u bë lajm. Shqetësuese është fakti që ndaj vajzave/grave është normalizuar gjuha mizogjene, dhe postimet ku gjinia femërore përmenden si rob të cilat mund t’i dhurosh si të ishin objekte janë të shpeshta. Normalizimi dhe dhënia e vëmendjes së komenteve dhe postimeve e rrit si dukuri gjuhën mizogjene ndaj grave.



Postimi u bë lajm nga Epilogu në ueb dhe në Facebook me titullin :“Mërgimtari kërkoi që vajzat t’ua jap Kurtit, qytetarët e Kosovës kërkojnë t’i ngritet përmendore Valon Sylës“, dhe ka gjeneruar 174 pëlqime, 44 komente dhe 6 shpërndarje.

<https://epilogu.com/mergimtari-kerkoi-qe-vajzat-tua-jap-kurtit-qytetaret-e-kosoves-kerkojne-ti-ngritet-permendore-valon-syles/>

Gjithashtu u ri postua në Facebook nga një portal me emrin Ylli.net dhe ka gjeneruar 81 pëlqime, 59 komente dhe 1 shpërndarje.



Epilogu publikon artikull me titull: **Vetëm pulat i kanë mbetur Vjosa Osmanit pa punësuar, rehatohen burri, vëllai, motra e dy tezaket** Presidentja e Kosovës vazhdimisht është pre e artikujve me tituj tendencioz dhe gjuhë mizogjene. Artikulli në fjalë ka përdorur metaforë në formë satire për të informuar lexuesit se po shfrytëzohet posti i presidentës për nepotizëm. Raportimi në fjalë cilësohet si i njëanshëm me qëllim që të shfaqet negativisht personi. Postimi në Facebook ka grumbulluar 87 ndërveprime të cilat janë 39 pëlqime/reagime, 32 komente dhe 9 shpërndarje.



Një tjetër artikull nga Epilogu me titull: **"Kimete Berisha: Donika Gërvalla është hajnesha më e shëmtuar, Kurti i duket luan budallicës"** Titulli në fjalë i vendosur në thonjëza nukpërbën informatë por vetëm një mendim të personal që cilësohet si mendim subjektiv. Përsëri, titulli kontribon në normalizimin e gjuhës mizogjene dhe ofenduese në sferën mediatike, duke zgjedhur mbiemra ofendues, në të njëjtën kohë nxitë qytetarët për të sulmuar gratë online. Postimi në Facebook ka grumbulluar 217 ndërveprime, prej të cilave janë, 153 pëlqime, 57 komente dhe 7 shpërndarje.

Polarizimi politik dhe gjuha e urrejtjes.

Titujt më poshtë kanë përzgjedhur fjalë me gjuhë ofenduese për të informuar publikun mbi ngjarjet politike në vend.

Një nga artikujt e postuar nga portali Epilogu me titull: **“Kurti ua tregon gishtin e mesit qytetarëve të Ferizajt, 0 cent për vitin 2024, ndërsa ata paguajnë 20% të tatimeve në krejt Kosovën”** cilësohet i njëanshëm dhe ndikon në perceptimin e lexuesve duke nxitur urrejtje dhe ndikuar në opinionet e tyre. Deklaratat e cituara dhe përzgjedhja e fjalëve në këtë rast që është vendosur në titull nuk përbën lajm/informacion, përbën opinion të personave, e që portalet i publikojnë në formë të lajmit dhe për lexuesit titujt me citime janë lajme dhe merren si fakte.



Epilogu poston një artikull tjetër me titull: **“Buzhala: Ani kur hajné m** disa e thojné është shkatërru Kosova në 20 vitet e fundit, o plluma të Jugosllavisë”**, edhe një herë gjuha dhe fjalët e përzgjedhura nga persona publik për të shprehur një mendim cilësohen si gjuhë ofenduese dhe nxitë vet lexuesit, kështu duke e thelluar probemin e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale. Në anën tjetër mediumi në fjalë zgjedh të vendos si titull pjesën me përmabjtje më ofenduese nga i gjithë postimi me qëllim që titulli të shfaqet sa më dramatik për të shtuar klikueshmërinë.

Portali Metro ka shkruar në njërin nga artikujt me titull **‘E mbyllë gojën kur unë jam këtu’ –Rozeta i hakmerret zyrtarit që e kishte kundërshtuar fuqishëm skandalin e rezervaveshtetërore**. Me të njëtin titull dhe portali Persikopi ka publikuar lajmin.



The screenshot shows the Metro Gazeta website interface. At the top, there is a navigation bar with the logo 'METRO GAZETA' and menu items: LAJME, OPINIONE, SPORT, EKONOMI, NDERKOMBETARE, JETE, ROZE. The main article title is **‘E mbyllë gojën kur unë jam këtu’ – Rozeta i hakmerret zyrtarit që e kishte kundërshtuar fuqishëm skandalin e rezervave shtetërore**. Below the title is a date and time: 29/12/2023 | 21:39. A large image shows a woman with curly hair (Rozeta Dhamo) and a man in a suit. To the right, there is a 'Rekomandime' section with three article thumbnails and titles: 'Njëri nga të dyshuarit për vrasjen e 18-vjeçarit në Podujevë ishte paraburgim edhe në vitin 2021', 'Kurti: ‘Ballkani i hapur’ s’është europian, BE e mjaftueshme për Ballkanin', and '4 shtyllat në të cilat bazohet i BE për ekonominë e Ballkanit Perendimor'. Below that is a 'Më të fundit' section with a thumbnail and title: 'Njëri nga të dyshuarit për vrasjen e 18-vjeçarit në Podujevë ishte paraburgim edhe në vitin 2021'.

Rastet e gjuhës ofenduese dhe nxitëse, të përdorur nga figurat politike kundër kolegëve, janë mjaft të shpeshta, sikurse në dy shembujt e parë edhe në artikullin në fjalë shfaqet gjuhë jo adekuatë e përdorur nga znj. Hajdari. Në të njëjtën kohë mënyra e raportimit nga mediumi cilësohet si karrem për klikueshmëri duke ekzagjeruar titullin, për ndryshim nga përmbajtja që ishte më neutrale në krahasim me titullin. Lexueshmëria në faqen online të mediumit ka arritur të grumbulloj 819 klikueshmëri/lexues pa ndëveprime

Rasti i Banjskës, me 24 shtator, ka shtuar narrativën në ambientin mediatik për mundësinë e një sulmi apo konflikt të dytë në Kosovë nga ana e Serbisë. Shembujt më poshtë janë vetëm disa nga i njeiti medium, Bota sot.

Artikujt e publikuar nga portali Bota sot:

Shteti ngre alarmin, paralajmëron sulme të reja nga Serbia 31 ndërveprime, prej të cilave janë 16 pëlqime, 5 komente dhe 10 shpërndarje.

Fitorja e Vuçiqit ngre alarmin e profesorit: Në 2024 pritet sulm në veri 53 ndërveprime, prej të cilave janë 42 pëlqime, 5 komente dhe 6 shpërndarje.

Alarmi nga Kurti/ A po përgatitet plani serb për aneksimin me luftë të veriut të Kosovës? 68 ndërveprime, prej të cilave janë 19 pëlqime 37 komente dhe 12 shpërndarje

“Vuçiq po përgatit aktin e radhës terrorist”, Bytyçi alarmon Kosovën: Ky është plani serb për zhbërjen e Kosovës 69 ndërveprime, prej të cilave janë 27 pëlqime, 1 koment dhe 41 shpërndarje.

Serbia sulm në Kosovë? Analisti zbulon zonën që rrezikon 27 ndërveprime, prej të cilave 7 pëlqime, 19 komente dhe 1 shpërndarje.



Artikujt me tituj në lidhje me konfliktin e mundshëm në Kosovë janë të bazuara në mendime personale Titutj në fjalë kanë ndikim te lexuesit dhe supozimet për një konflikt të mundshëm pasiguri dhe frikë te qytetarët pasi që mund të merret si diçka e vërtetë, me qëllim që të ketë ndërveprime dhe klikueshmëri të lartë. Lajmet e paverifikuara në përgjithësi merren si të vërteta, gjë që ndotë sferën mediatike.

Në total, portali Bota Sot ka pasur 335.3 mijë klikime nga lexuesit pa ndërveprime, vetëm gjatë muajit dhjetor.

6. SHEMBUJ NË GJUHËN SERBE

Narrativa e spastrimit etnik vazhdimisht vjen nga zyrtarë serb që mbushin sferën mediatike në Serbi me lajme të pavërteta dhe të paverifikuara. Deklarata e Petar Petkovic: “aksioni i sotëm i Prishtinës në fshatin Banjaskë është pjesë e planit “për spastrimin etnik të serbëve” nga Kosova dhe Metohia”, mbushi sferën mediatike.



Novosti: **DEMONSTRIMI I FORCËS: Petar Petković për pushtimin e sotëm të të ashtuquajturit të Policisë së Kosovës në kompleksin Rajska Banja.** Ky medium ka arritur të grumbullojë 2.3 milion klikueshmëri/lexues në faqen online.

Kosovo online: **PETAR PETKOVIQ: Aksioni i sotëm i Prishtinës në fshatin Banjaskë është pjesë e planit të spastrimit etnik të serbëve nga Kosova dhe Metohia.** Ky medium ka arritur të grumbullojë 120.9 mijë /lexues në faqen online.

Kossev.info: **Petković: Me hyrjen në kompleksin “Rajska banja”, Prishtina konfirmoi synimin e saj për të pushtuar veriun.** Ky medium ka arritur të grumbullojë 69.1 mijë klikueshmëri/lexues në faqen online.

Tanjug: **Petar Petković: Aksioni në kompleksin “Rajska banja” në Banjska është pjesë e planit të spastrimit etnik të serbëve.** Ky medium ka arritur të grumbullojë 189 mijë klikueshmëri/lexues në faqen online.

Narrativa e “spastrimit etnik” përhapet pothuajse në të gjitha mediat në Serbi kotribon në ndarjet etnike dhe nxitjen e urrejtjes në mes serbëve dhe shqiptarëve. Duke marrë parasysh se raportet Kosovë-Serbi kanë qenë çdo herë delikate, narrativat në fjalë rrezikojnë të sjellin konflikte.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org

Mbështetur nga:

